



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:063190

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505388

PKR.nr.146/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes-Gjyqtari Fatos Sejdiqaj, me zyrtarin ligjor Bardh Sylejmani-procesmbajtës, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit J.Th.me adresë vendbanimi në Prishtinë, për shkak të veprës penale – Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Mitrovice-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.120/2022, të datës 06.06.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 21.03.2024 i cili ka qenë i hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e Shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari J.Th.dhe Mbrojtësi i tij, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Muharrem Ramadani, më datën 26.03.2024 e mori dhe publikisht e shpalli, e po me këtë datë e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

- I akuzuari :

J.Th., nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., me adresë vendbanimi në Prishtinë, Rr.”...” Hyrja –., Nr....., me numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer Fakultetin e Gazetarisë, i martuar – baba ... fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

- ËSHTË FAJTOR -

-SEPSE : Me datën 06.10.2019, në Shkollën Filllore “Skender Skenderi” në fshatin ..., i pandehuri në cilësinë e Kryesuesit të Këshillit të Vendvotimit në Qendrën e Votimit 2110B, vendvotimi me Nr.2110B/02D duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autoritetin zyrtar në lidhje me zgjedhjet ka shtuar dhe hequr votat, në atë mënyrë që pas rinumërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve është

bërë krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, ashtu që gjatë numërimit të votave të kandidatëve brenda subjektit politik, ka hequr votat e disa kandidatëve dhe i ka shtuar të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 322 vota, ku prej tyre 217 vota të shtuara dhe 105 vota të hequra.

- Me këtë ka kryer veprën penale – Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 71 par.1 pika 1.3, 72 par.1 pika 1.3 dhe nenit 216 par.2 të KPRK-së, lidhur me nenin 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së të akuzuarin e :

- G J Y K O N -

I.- Me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit prej dy (2) viteve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do kryejë vepër tjetër penale.

II.- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.- Kërkesë pasurore – juridike nuk kishte.

- A r s y e t i m -

- Rrjedha e çështjes –

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.120/2022 të datës 06.06.2022, kundër të akuzuarit J.Th.nga Prishtina, për shkak të veprës penale-Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale më datë 21.03.2024 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ish-in prezent Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari J.Th.dhe Mbrojtësi i tij, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Muharrem Ramadani.

- Gjykata konform nenit 241 par.1 të KPP-së, të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, sa i përket mbrojtjes në këtë çështje penale ka

deklaruar se meqë nuk ka mundësi financiare, pajtohet që të mbrohet përmes mbrojtësit të tij, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Muharrem Ramadani

- Duke qenë se në këtë çështje penale i akuzuari akuzohej për veprën penale-Falsifikimi i rezultateve të votimit nag neni 216 par.2 të KPRK-së, për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, meqë mbrojtja është e detyruar, me aktvendim procedural Gjykata duke vepruar në përputhje me nenin 56 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike të akuzuarit i është caktuar Av.Muharrem Ramadani nga Mitrovica.

- Vlerësimi i pranimi të fajësisë –

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, Gjykata të akuzuarin e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe beneficionet e pranimi të fajësisë, ashtu që i njëjti pas këshillimeve të mjaftueshme më Mbrojtësi e tij, ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare dhe pa imponime njëherësh, shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, duke shprehur pendimin e tij të thellë lidhur me veprimet e tij, duke i propozuar gjykatës që ndja tij të shqiptjë një dënim sa më të butë pasi që, ka theksuar se është mbajtës kryesor i familjes prej pesë (5) anëtarëshe, i papunë, ndërsa bashkëshorten e kam me gjendje të rëndë shëndetësore-epilepsi për çka lidhur me këtë Gjykatës i dorëzoi raportet mjekësore në emër të saj.

- Pas pranimi të fajësisë nga i akuzuari, Gjykata e kërkojë mendimin nga Prokurorja e shtetit, e cila me këtë rast deklaroi se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që këtë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime pas këshillimit të mjaftueshëm me Mbrojtësin e tij, e që pranimi i fajësisë gjenë mbështetje dhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës andaj, i propozojë Gjykatës që ta aprovojë pranimin e fajësisë.

- Poshtua, Gjykata e kërkojë mendimin dhe nga Mbrojtësi i të akuzuarit i cili përveç tjerash deklaroi se, e mbështetë pranimin e fajësisë nga i akuzuari, i njëjti është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me të si Mbrojtës dhe këtë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime pas njoftimit nga Gjykata me privilegjet e pranimi të fajësisë. Përveç kësaj, ka kërkuar nga Gjykata që me rastin e matjes së dënimit, të vlerësojë rrethanat lehtësuese ndaj tij dhe atë; pranimin e fajësisë, gjendjen e tij të varfër ekonomike-si i papunë dhe i vetmi mbajtës i familjes pesë anëtarëshe në të cilën dhe i gruas së tij të sëmurë, faktin se ishte shumë i singertë, është penduar dhe premtion se në të ardhmen nuk do të kryejë asnjë veprë tjetër penale.

- Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari dhe pas marrjes së mendimit nga Prokurorja e shtetit dhe Mbrojtësi i të akzuarit, Kryetari i trupit gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 242 par.6 lidhur me par.2 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka miratuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës ngase, konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Gjykata ia kishte tërhequr vërejtjen të akzuarit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e njëjta është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

- Gjendja faktike e vërtetuar –

- Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i akuzuari në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, Gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të akzuarit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale-Falsfikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së, për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, e që kjo konstatohet dhe nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si : Deklarata e të pandehurit dhënë në polici me datë 05.04.2022; Libri i votimit për Vendvotimin 2110B/02D; Formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve e krijuar në Vendvotimin Nr.2110B/02D dhe FPR e rinumëruar në QNR; Formulari i përputhjes së të dhënave të kandidatëve (FRK) e krijuar në vendvotim Nr. 2110B/02D dhe në rinumërim në QNR; Tabela (excel) e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektit politik, dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotimin dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë hequr apo shtuar) si dhe shkresat tjera të lëndës.

- Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i akuzuari, është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet, për çka Gjykata i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –

- Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit Gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë tjetër lehtësuese Gjykata mori rrethanat e tij personale, familjare dhe ekonomike-se i njëjti është baba i tre (3) fëmijëve, i papunë, gjenden e rëndë shëndetësore të bashkëshortës së tij, për çka Gjykatës i ka dorëzuar raportet mjekësore në emër të saj të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pastaj pendimin e tij të thellë si dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me veprimet e tij, se në shkresat e lëndës nuk ka prova që e dëshmon se ka ndonjë procedurë tjetër penale ndërsa, **si rrethanë rënduese** në rastin konkret Gjykata gjeti shkallën e dashjes dhe përgjegjësisë penale të tij.

- Ndaj të akuzuarit, Gjykata vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1, pika 1.3 të KPRK-së, në të cilën dispozitë ligjore parashihet se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rast kur kryesi pranon fajësinë. Në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ai akuzohet, andaj për këtë arsye Gjykata të njëjtit fillimisht i shqiptojë dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjor për këtë vepër penale, e pastaj vendosi që të njëjtin dënim t'ia kushtëzojë për kohën e verifikimit prej dy vitesh.

- Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit e ka bërë brenda kufijve për zbutjen e dënimit të paraparë në dispozitën ligjore nga neni 72 par.1, pika 1.3 të KPRK-së, në të cilën parashihet : *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënim me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënim mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”*. Në rastin konkret për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së, është paraparë dënim me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet. Pra, siç shihet për këtë vepër penale kufiri i zbutjes së dënimit ka qenë dënim me burgim prej një (1) viti.

- Prandaj, bazuar në arsyet dhe rrethanat e sipërtheksuara, Gjykata dënimin me burgim të akuzuarit ka vendosur që t'ia kushtëzojë për periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve, duke vlerësuar se është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarës.

- Andaj, Gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin

38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, Gjykata e mori duke u bazuar në nenet 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj Gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.146/2022, datë 26.03.2024.

Zyrtari ligjor

Bardh Sylejmani

Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.